



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINSTRIT**

U R D H Ë R

Nr. 139 datë 01.07.2010

PËR

**ZBATIMIN E PROCESIT TË MONITORIMIT TË STRATEGJIVE
SEKTORIALE E NDËRSEKTORIALE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të strategjisë së ripunuar, “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, miratuar me vendimin nr. 692, datë 10.11.2005, të Këshillimit të Ministrave,

URDHËROJ:

1. Përgatitjen nga cdo ministri, të Matricës së Vlerësimit të Rezultateve (MVR), e cila zëvendëson Planet e Integruara të Ministrive (PIM). Matrica e Vlerësimit të Rezultateve është instrumenti i monitorimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar.
2. Matrica e Vlerësimit të Rezultateve zbatohet për planifikimin e politikave kombëtare dhe të buxhetimit mbështetur në performancën, analizën e politikave të programeve buxhetore, si dhe llogaridhënien me qëllim rritjen e transparencës.
3. Matrica e Vlerësimit të Rezultateve përfshin tabelat e planifikimit dhe tabelat e monitorimit, të cilat përmbajnë tregues dhe qellime të përcaktuara në nivelin e objektivave të strategjive dhe të programeve buxhetore të ministrive. Treguesit dhe qellimet përcaktohen në menyre

të tillë që të jenë të posaçëm, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe të përcaktuar për një periudhë kohore të caktuar.

4. Veprimet dhe masat e planifikuara për të arritur objektivat kryesore të strategjive, siç janë përcaktuar nga ministritë përkatëse, përshkruhen në tabelat e planifikimit.
5. Tabelat e monitorimit përshkruajnë veprimet dhe masat e ndërmarra kundrejt masave të planifikuara me qëllim përcaktimin e rezultateve mbi arritjet sipas programeve dhe strategjive.
6. Ministritë duhet të përfundojnë tabelat e planifikimit, brenda muajit qershor të çdo viti kalendarik, përpara procesit për përgatitjen e buxhetit vjetor. Gjithashtu, tabelat e monitorimit, duhet të përfundojnë, brenda muajit dhjetor të çdo viti, përpara përgatitjes së politikave prioritare.
7. Ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore, që lidhen me zbatimin e strategjive përkatëse sektoriale dhe ndërsektoriale, ngarkohen si struktura përgjegjëse në ministritë e linjës të angazhuara me përgatitjen e Matricave të Vlerësimit të Rezultateve.
8. Sekretarët e përgjithshëm të ministrive të linjës luajnë rol koordinues për përgatitjen e Matricave të Vlerësimit të Rezultateve, duke organizuar procesin për përgatitjen dhe diskutimin e matricave në Grupin për Strategji, Buxhet dhe Integrim, si edhe duke marrë miratimin me shkrim të ministrit përkatës përpara paraqitjes në DEBASKON të matricave.
9. Ngarkohet Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON), në Kryeministri të koordinojë në nivel qendror procesin e përgatitjes së Matricave të Vlerësimit të Rezultateve nga ministritë e linjës. Për kryerjen e këtij funksioni, DEBASKON zhvillon seanca dëgjimore me ministritë e linjës në periudhat maj-qershor dhe nëntor-dhjetor të çdo viti kalendarik.
10. Formatet dhe udhëzimi për përgatitjen e Matricës së Vlerësimit të Rezultateve, përfshirë tabelat e planifikimit, tabelat e monitorimit, kalendarin dhe listën e strategjive për tu monitoruar, i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij urdhëri.

11. Urdhëri nr.192, datë 04.08.2006, i Kryeministrit, “Për përgatitjen e planeve të integruara të ministrive”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA